



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI I KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

BORDI I RTK-së

shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të lirë të punës:

Auditor i brendshëm në RTK (nr. 2029)

1 pozitë

Detyrat

- Kryen detyrat e auditimit në pajtueshmëri me Planin strategjik dhe atë vjetor;
- Vlerësim i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në relacion me identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve;
- Pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret, rregullat e brendshme dhe kontratat;
- Besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacioneve;
- Efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomicitetin e operacioneve;
- Ruajtjen e pasurisë dhe informacioneve;
- Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimeve;
- Kryerjen e detyrave, plotësinë e dosjeve dhe saktësinë e informatave në to;
- Përgatitjen e Letrave të punës për çdo fazë të auditimit, grumbullimin dhe arkivimin e dëshmive të auditimit si dhe përgatitjen e inputit për raport për aktivitetin e mbuluar gjatë auditimit individual. Secili auditor bartë përgjegjësi individuale për mbajtjen e Letrave të punës, dëshmitë e auditimit, vërtetësinë dhe saktësinë e tyre, si dhe për çdo keqinterpretim apo shtrembërim të tyre.

Kushtet

- Kandidatët duhet të posedojnë diplomë universiteti në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo juridik;
- Certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave;
- Njohja e Legjislativit në Republikën e Kosovës;
- Kandidatët duhen të ketë së paku 3 vite përvojë profesionale;
- Të kenë njohuri të mira nga financa dhe kontabilitetit;
- Të kenë njohuri për reziqet afariste të kontrollit të brendshëm;
- Njohuri pune me kompjuter (word, excel, outlook, internet);

- Të zotërojë ndonjëherë nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, në të folur dhe në të shkruar;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë;
- Është person me integritet të lartë personal dhe profesional.

Për këtë vend të punës është e paraparë kontrata e punës me kohë të caktuar me periudhë provuese prej tre muajve.

Kandidatët e paraqitur për këtë vend të punës duhet:

- të mos kenë angazhime, biznese, etj. të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi;
- të mos kenë asnjë angazhim tjetër shtesë të punës jashtë këtij vendi të punës;
- të mos jetë tri (3) vitet e fundit në organet e larta udhëheqëse politike.

Kandidatët e paraqitur për këtë vend të punës duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Dëshmitë e kualifikimit universitar në origjinal ose të noterizuara, (për diplomat e fituara jashtë vendit duhet të dorëzohet vendimi për nostrifikim në origjinal ose i noterizuar),
- Certifikata e auditorit të brendshëm;
- CV;
- Letër motivuese;
- Certifikata e lindjes;
- Fotokopjen e letërnjoftimit ose e pasaportës e Republikës së Kosovës;
- Dëshmi mbi përvojën e punës. Dëshmimi i përvojës së punës duhet të bëhet nëpërmjet kontratave të punës apo vërtetimeve të punës të lëshuara nga punëdhënësit mbi marrëdhënien e punës;
- Dy letra referuese profesionale (dy letrat referuese duhet të lëshohen nga punëdhënësit/mbikëqyrësit paraprak dhe/ose aktual);
- Dëshmi nga Gjykata që nuk janë dënuar me vendim të plotëfuqishëm për veprë penale të dënueshme më shumë se gjashtë muaj (të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit);
- aplikacionin i cili duhet të shkarkohet nga ueb-faqja e RTK-së:
<https://www.rtklive.com/sq/docs/2022-02-05/231.doc>

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuar, në mënyrë elektronike, përmes internet adresës yllkaasimi@rtklive.com, prej **15.11.2022** deri më datë **29.11.2022** në orën **16:00**.

Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.

Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret në konsiderim.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.